



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
P R O J E K T V E N D I M

Nr. _____, datë _____

**“PËR
DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 858, DATË 29.12.2021, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË
PROCEDURAVE E TË DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE
TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 pika 1 dhe 12, shkronja “e”, 19 pika 4, 21 pika 3, 23 pika 1, 29 pikat 1 e 6, 33 pika 6, 33/1 pikat 10 dhe 12, 36 pika 4, 37 pikat 1 e 4, 56 pika 7, 81 pika 4, 84 pika 4, 91 pika 3 dhe 140 pika 1, të ligjit nr. 79/2021 “Për të huajt” të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në tekst fjalët “Ministri i Brendshëm” dhe “Ministria e Brendshme” zëvendësohen përkatësisht me fjalët “Ministri i Punëve të Brendshme” dhe Ministria e Punëve të Brendshme”.
2. Në Kreun II “Kriteret dhe dokumentacioni për pajisjen me vizë”
 - 2.1. Në Seksionin “A”,
 - në pikën 3, gërma “b”, pas fjalës: “...lëshuar nga...” shtohen fjalët “...vendet e Bashkimit Evropian...”;
 - në pikën 4, pas fjalës “...me vizë...” shtohen fjalët “në Misionet Diplomatieke dhe Postet Konsullore ku kryhet aplikimi...”;
 - në pikën 7, pas fjalës “...on-line” shtohen fjalët “...duke qenë jashtë territorit të RSH-së...” dhe pas fjalës “...personalisht” shtohen fjalët “...në Misionin Diplomatik apo Postin Konsullor...”;

2.2. Në Seksionin “B”,

- në pikën 5, gërma “a”, në fund të paragrafit të shtohen fjalët: “me afat vlefshmërie jo më pak se 3 muaj.”;
- shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:
“6. Leje qëndrimi mbi 12 muaj nga vendi ku i huaji është rezident, me vlefshmëri të paktën 3 muaj më shumë se afati i vizës së kërkuar/ose viza të mëparshme apo aktuale (Shengen, SHBA, Mbretëri e Bashkuar) ose viza shqiptare elektronike/pullë.”.

2.3. Në Seksionin “C”,

- në pikën 2, shtohet gërma “d” me këtë përmbajtje:
“d) kopje të lejes së qëndrimit të vendit ku shtetasi është rezident, kopje të vizave të vlefshme aktuale, kopje të lejeve të qëndrimit dhe/ose vizave të skaduara, si dhe kopje të vulave të hyrje-daljeve të 5 viteve të fundit.”;
- në pikën 2.1. shtohet gërma “d” me këtë përmbajtje:
“d) kopje të lejes së qëndrimit të vendit ku shtetasi është rezident, kopje të vizave të vlefshme aktuale, kopje të lejeve të qëndrimit dhe/ose vizave të skaduara, si dhe kopje të vulave të hyrje-daljeve të 5 viteve të fundit.”.
- në pikën 2.2, gërma “b”, në fund të fjalisë, shtohen fjalët “...si dhe biletën e udhëtimit vajtje-ardhje.”;
- në pikën 2.3, gërma “b”, në fund të fjalisë, shtohen fjalët “...me përkthim jo zyrtar në anglisht ose shqip.”;
- në pikën 2.5, shtohet pika “c” me këtë përmbajtje:
“c) biletën e udhëtimit vajtje-ardhje.”;
- në pikën 3, në titull, pas fjalës “...tipi “D”” shtohen fjalët “...dhe leje unike për shtetasit që i nënshtrohen regjimit të vizave.”;
- në pikën 3.1,
 - gërma “b” riformulohet me këtë përmbajtje:
“b) Fotografia e aplikuesit, e cila duhet të jetë bërë jo më përpara se 6 (gjashtë) muaj nga data e aplikimit, me përmasa 47 mm x 36 mm, e marrë në plan me sfond të bardhë, e fokusuar dukshëm dhe qartë. Fotografia duhet të tregojë personin përballë, me shprehje neutrale dhe sytë të hapur e të dukshëm.”;
 - në gërmën “c”, pas fjalës “...(CV)...” shtohen fjalët “...për profesionet e lira...”;
 - në gërmën “ç”, pas fjalëve “...higjieno-sanitare...” shtohet fjalia “bashkëlidhur certifikaten e prones së pritësit, ose kontratë qiraje, kontratë huapërdorje ose deklaratë noteriale.”
 - shtohet gërma “e” me këtë përmbajtje:
“e) certifikatë e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) të marrë jo më përpara se 3 muaj nga data e aplikimit, përjashtuar për aplikimet për vizë të tipit D/DS si dhe për të gjitha tipet e vizës D për aplikantë nën moshën 16 vjeç dhe mbi moshën 75 vjeç”.
- në pikën 3.2, shtohet gërma “ç” me këtë përmbajtje:
“ç) Vërtetim që pritësi ka sasi të mjaftueshme të ardhurash për të siguruar jetën e personit/personave që do të vijnë në Republikën e Shqipërisë.”;

- në pikën 3.5, gërma “b” pas fjalës “...financiare...” shtohen fjalët “...në gjuhën shqip dhe/ose angleze...” dhe pas fjalës “300 000 lekë...” shtohen fjalët “...ose në vlerën ekuivalente në euro,...”;
- në pikën 3.10/1, shtohet gërma “b” me këtë përmbajtje:
“b) Kontrata e punës si punëmarrës me një punëdhënës në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, në gjuhën shqipe.”.
- shtohet pika 3.10/2 me këtë përmbajtje:
“3.10/2. Dokumentacioni shtesë për vizë tipi “D” si punëtor shtëpie (D/PSH):
a) Kopje të regjistrimit në QKR-së dhe organeve përkatëse të tatimeve të punëdhënësit
b) Miratim për punësim online nga AKPA-ja;
c) Kontratë e vlefshme e punës si punëtor shtëpie, ku përcaktohet kohëzgjatja e afatit dhe natyra e punës.”
- Në pikën 3.13, shtohen gërmat “c” dhe “ç” me këto përmbajtje:
“c) Dokument që vërteton se i huaji është i regjistruar në federatën e sportit në vendin e origjinës .
ç) Kontrata e punës si punëmarrës me subjektin ftues në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, në gjuhën shqipe.”;
- në pikën 3.16, gërma “c” në fund të fjalisë shtohen fjalët “i cili lëshohet nga institucioni përkatës.”;
- në pikën 3.18, gërma “a” ndryshon dhe bëhet:
 - “a)Vërtetimin e regjistrimit në QKB me vlerën e investimit të përcaktuar në udhëzimin e përbashkët;”
 - Shtohet gërma “b” me këtë përmbajtje: “b)Planin e Biznesit.”.

3. Në Kreun III, “Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pajisjen me leje qëndrimi”,

1.1. Seksionin “A”,

- pika 1.1, riformulohet me këtë përmbajtje: “1.1. Pas pranimit të kërkesës, autoriteti i kufirit dhe migracionit pajis brenda 1 (një) ditë pune të huajin me leje provizore, me afat vlefshmërie 1 (një) muaj, e cila zgjatet për atë kohë sa është e nevojshme për marrjen e vendimit për miratimin apo refuzimin e kërkesës për pajisjen me leje qëndrimi apo leje unike.”;
- në pikën 6, pas fjlëve “...për raste humanitare” fjalia riformulohet “...për personat pa shtetësi, për qëndrim të përhershëm dhe për motive të tjera,...”;
- në pikën 9, në fund të paragrafit shtohet fjalia “Ky detyrim zbatohet vetëm kur shtetasi i huaj aplikon për herë të parë për leje qëndrimi apo unike.”
- pika 10, riformulohet me këtë përmbajtje:
“10. Për kategoritë e lejeve, të cilat kërkojnë dëshmi të burimeve të mjaftueshme financiare për jetesën në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë vendim, ajo konsiston në:
a) paraqitjen e një vërtetimi depozite bankare në bankat e nivelit të dytë, personale apo familjare, në Shqipëri, jo më pak se 300 000 lekë për person (për 1 (një) vit kalendarik) .

- b) Për të huajt, që qëndrojnë për motive studimi, pranohet edhe dokument vërtetues për burime të tjera, që rrjedhin nga një grant, një bursë studimi, një kontratë e vlefshme pune ose një ofertë pune, jo më pak se 300 000 lekë për person, për 1 (një) vit kalendarik;
- c) vërtetim i të ardhurave mujore jo më pak se paga minimale në Republikën e Shqipërisë.”

1.2 Në Seksionin “B”,

- shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:
“2/1 certifikatë e gjendjes gjyqësore (dëshmi penalteti) të marrë jo më përpara se 6 muaj nga data e aplikimit, për të gjitha llojet e lejeve të qëndrimit përjashtuar për aplikantë nën moshën 16 vjeç dhe mbi moshën 75 vjeç.”;
- në pikën 3, në fund të fjalisë shtohen fjalët “në të cilin të jetë përcaktuar qartë adresa e vendbanimit.”.

1.3 Në Seksionin “C”, pika 2

- në gjermën “ë”, pika v, riformulohet me këtë përmbajtje:
“v. Dokumentin se është i kategorizuar si i mitur i braktisur ose ka mbetur pa mbrojtje prindërore, kujdestari apo shoqërues për arsye të tjera dhe një kërkesë formale për leje qëndrimi nga i mituri ose kujdestari ligjor.”
- shtohet gjërma “gj” me këtë përmbajtje:
“gj) Dokumentacioni shtesë për leje qëndrimi për investitorë:
 - i. Vërtetimi i regjistrimit në QKB me vlerën e investimit të përcaktuar në udhëzimin e përbashkët;”
 - ii. Plani i Biznesit.”

1.4 Në Seksionin “Ç”,

- në pikën 1, pas fjalës “...e cila është...” shtohet fjalia “...e pakthyeshme dhe është e vlefshme për një periudhë 30 ditore për riaplikim në rast refuzimi.”;
- shtohet pika 1.1 me këtë përmbajtje: “1.1 Pas pranimit të kërkesës, autoriteti i kufirit dhe migracionit pajis brenda 1 (një) dite pune të huajin me leje provizore, me afat vlefshmërie 1 (një) muaj.”;
- në pikën 9, fjala “prej 12 javësh” bëhet “prej 4 javësh”.

1.5 Në Seksionin “D”,

- në gjermën “b” shtohet pika nënpika “ii” me këtë përmbajtje:
“ii) Dokument që vërteton që i huaji plotëson kushtet e përcaktuara në ligj në rastet kur aktiviteti që do të ushtrojë bën pjesë te profesionet e rregulluara. (diploma/certifikatë profesionale /referenca).”
- pas gjermës “gj” shtohet gjërma “gj/1” me këtë përmbajtje:
“gj/1 Dokumentacioni shtesë për leje unike punëtor shtëpie
 - i) Vërtetimin e regjistrimit në organet tatimore;
 - ii) Miratim për punësim online nga AKPA-ja;

- iii) Kontratë e vlefshme e punës si punëtor shtëpie, në përputhje me kodin e punës, ku përcaktohet kohëzgjatja e afatit dhe natyra e punës.”
- Në gërmën “h”, gërma “c”, nënpika “ii” ndryshon dhe bëhet: “ii. vetë deklaram për akomodim të përshtatshëm në RSH.”
- Në gërmën “DH” shtohet pika “iii” me këtë përmbajtje:

“iii. Për ripërtëritjen e lejes së qëndrimit, dokumentacioni nga vendi i origjinës së të huajt, i cili është dorëzuar në aplikimin për herë të parë për lëshimin e lejes të përkoshme të qëndrimit, nuk është më i nevojshëm të jetë i lëshuar sipas detyrimeve të parashikuara nga Kreu III, pika 9 e kësaj VKM-je. Për rastet e bashkimit familjar, në rast se martesë midis shtetasve është lidhur jashtë territorit të RSH dhe i huaji e ka të pamundur dorëzimin e certifikatës së martesës të lëshuar në 6 mujorin e fundit, apo dorëzimin e certifikatës familjare apo personale nga vendi i origjinës, i huaji/ të huajt/shqiptari, duhet të dorëzojë para autoriteteve vendore të kufirit dhe migracionit, deklaratë e përbashkët noteriale të 6 mujorit të fundit të kryer para një noteri publik shqiptar se regjimi martesor midis tyre nuk ka ndryshuar, se bashku me një kopje të këtyre certifikatave të përkthyer në gjuhën shqipe nga një përkthyes i licensuar i gjuhës shqipe nga Ministria e Drejtësisë Shqiptare. I njëjti dokumentacion paraqitet dhe nga partnerët civilë në rastet e bashkimit familjar si partner civil. Për të miturit minorenë, në çdo rast të ripërtëritjeje leje qëndrimi, kërkohet miratimi i përbashkët noterial i të dy prindërve, i vlefshëm për 6 -mujorin e fundit. Kjo procedurë është e vlefshme për të gjitha rastet e bashkimit familjar në rastet e ripërtëritjeve të lejeve të qëndrimit.”

4. Pas Kreut III, shtohen Krerët IV dhe V, me këtë përmbajtje:

IV. PROCEDURA, KRITERET DHE DOKUMENTACIONI PËR LËSHIMIN E “CERTIFIKATËS SË REGJISTRIMIT” PËR SHTETASIT E VENDEVE TË BASHKIMIT EVROPIAN

A. Qëllimi dhe fushëveprimi

- a) Ky seksion përcakton procedurën e aplikimit, dokumentacionin dhe kriteret për pajisjen me “Certifikatë regjistrimi” të shtetasve të vendeve të Bashkimit Evropian, të cilët qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë për periudha më të gjata se tre (3) muaj, në përputhje me nenin 33/1 të ligjit nr.79/2021 “Për të huajt”, të ndryshuar.
- b) Dispozitat e këtij seksioni zbatohen vetëm për shtetasit e BE-së dhe nuk shtrihen mbi anëtarët e familjes që nuk janë shtetas të BE-së.

B. Procedura e aplikimit

- a) Aplikimi kryhet elektronikisht përmes portalit qeveritar e-Albania dhe i drejtohet autoritetit përgjegjës për kufirin dhe migracionin. Aplikanti ngarkon dokumentacionin dhe plotëson formularin elektronik sipas Aneksit nr.12, bashkëlidhur këtij vendimi.
- b) Pas dorëzimit të aplikimit dhe dokumentacionit, autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin kryen verifikimin e dokumentacionit dhe të dhënave brenda 5 ditëve pune.
- c) Në rast të mangësive, aplikanti njoftohet on-line për të plotësuar dokumentacionin brenda afatit 5-ditor.
- ç) Pas përfundimit të verifikimit, autoriteti për kufirin dhe migracionin i lëshon të huajt certifikatën e regjistrimit në format elektronik.C. Kriteret dhe dokumentacioni për pajisje me certifikatë regjistrimi:

C) Kriteret dhe dokumentacioni për pajisje me certifikatë regjistrimi:

1. Shtetasi i BE-së paraqet on-line dokumentat e mëposhtme, sipas kategorisë përkatëse:

Dokumentacioni bazë (i detyrueshëm për të gjithë aplikantët)

- i. Pasaportë ose letërnjoftim i vlefshëm i vendit anëtar të BE-së;
- ii. Dokument që vërteton hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- iii. Deklaratë mbi adresën e vendqëndrimit në Shqipëri;
- iv. Fotografi;
- v. Deklaratë përgjegjësie mbi saktësinë e të dhënave.

2. Shtetasi i BE-së pajiset me certifikatë regjistrimi nëse plotëson një nga kategoritë si më poshtë:

a) Punëmarrës ose i vetëpunësuar

- i. kontratë pune ose deklaram i punësimit nga punëdhënësi;
- ii. paraqet dokumentacion që vërteton veprimtarinë e vetëpunësimit në Republikën e Shqipërisë.
- iii. NIPT (në rastet kur është i vetëpunësuar);

b) Person me burime të mjaftueshme

- i. deklaron dhe vërteton zotërimin e burimeve të mjaftueshme financiare për veten dhe anëtarët e familjes, që të mos bëhen barrë për sistemin e ndihmës sociale;
- ii. zotëron policë të vlefshme të sigurimit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë.

c) Student

- i. vërtetim regjistrimi nga institucioni arsimor;
- ii. policë sigurimi shëndetësor;
- iii. ideklaratë ose dokument provues për burime të mjaftueshme financiare.

c) Anëtar familjeje i shtetasit të BE-së

- i. shoqëron ose bashkohet me shtetasin e BE-së që plotëson kriteret sipas shkronjave “a”, “b” ose “c”;
- ii. për qëllimet e këtij seksioni, kjo shkronjë zbatohet vetëm për anëtarët e familjes që janë vetë shtetas të BE-së.

V. PROCEDURA, KRITERET DHE DOKUMENTACIONI PËR LËSHIMIN E “KARTËQËNDRIMIT TË NJË ANËTARI TË FAMILJES SË NJË SHTETASI TË BE-së”

A. Kriteret për pajisjen me kartëqëndrimi të një anëtar të familjes të një shtetasi të BE-së, që nuk është shtetas i BE-së:

1. Dokumentacioni i kërkuar

Aplikanti dorëzon online dokumentet e mëposhtme:

a) Dokumentacioni bazë:

- i. Dokument udhëtimi i vlefshëm (pasaportë);
- ii. Dokument që provon hyrjen ligjore në territor;
- iii. Fotografi
- iv. Deklaratë e adresës së përbashkët të qëndrimit në Shqipëri;
- v. Deklaratë përgjegjësie për saktësinë e të dhënave.

b) Dokumentacioni për lidhjen familjare:

Sipas rastit:

- i. Certifikatë martese;
- ii. Certifikatë bashkëjetese
- iii. Certifikatë lindjeje për fëmijët e bashkëshortit ose bashkëjetuesit nën 21 vjeç;

Dokumentet e huaja duhet të jenë të legalizuara / apostiluara dhe të përkthyer në shqip.

c) Dokumentacioni i shtetasit të BE-së

- i. Kopje e Certifikatës së Regjistrimit;
- ii. Dokument identifikimi i vlefshëm;
- iii. Dëshmi të plotësimit të kriterëve sipas kategorisë së qëndrimit (punë, studime apo burime të mjaftueshme), vetëm nëse kërkohen nga autoriteti për verifikim.

B. Procedura e aplikimit

- a) Aplikimi kryhet online në portalin e-Albania dhe i drejtohet autoritetit përgjegjës për kufirin dhe migracionin.
- b) Aplikanti ngarkon dokumentacionin dhe plotëson formularin elektronik sipas Aneksit nr.11, bashkëlidhur këtij vendimi.
- c) Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin kryen verifikimin brenda 52 ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë.
- d) Në rast mangësish, aplikanti njoftohet elektronikisht për t'i plotësuar brenda 5 ditëve pune.
- e) Pas miratimit, autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin lëshon “Kartëqëndrimin e një anëtarit të familjes së një shtetasi të BE-së”.

C. Revokimi

- a) Karta e qëndrimit revokohet kur:
- b) Shtetasi i BE-së nuk plotëson më kriteret e qëndrimit;
- c) Lidhja familjare ka pushuar të ekzistojë;
- d) Janë paraqitur dokumente të falsifikuara;
- e) Ekzistojnë rrethana që cenojnë rendin dhe sigurinë publike sipas ligjit.

5. Kreu IV “Dispozita të fundit dhe kalimtare” bëhet Kreu VI, dhe riformulohet me këtë përmbajtje:

“VI. “Dispozita të fundit dhe kalimtare”

1. “Procedura e aplikimit për lejen e qëndrimit për investitor, lejen Unike për punëtor shtëpie, për Certifikatë Regjistrimi dhe Kartëqëndrimi, do të jetë funksionale pas reflektimit në e-albania të ndryshimeve të parashikuara në Kreun IV, Seksioni B, gërma “a” dhe Kreu V, Seksioni B, gërma “b”.
2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, reflektimin në platformën e-albania të parashikimeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij Kreu, brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi”

6. Në Aneksë, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Aneksi 6,
 - a) në titull, në fund të fjalisë shtohën fjalët: “... si dhe Certifikatë Regjistrimi dhe Kartëqëndrimi.”
 - b) në tabelë, shtohet pika 28, me këtë përmbajtje: “Certifikata e Regjistrimit dhe Kartëqëndrimi, janë pa tarifë shërbimi.”
- Aneksi 8,

Në Seksionin B,

- a) pika 2.1 “Cilat janë arsyet e qëndrimit për motive punësimi në Shqipëri?”, kategoria “Investitor” hiqet dhe zëvendësohet me kategorinë “Punëtor shtëpie”;
- b) Seksioni 2.3 “Informacion mbi punësimin” riformulohet me këtë përmbajtje:

“2.3 “Informacion mbi punësimin”

- NIPT i biznesit
- Të dhënat e biznesit (me një listë e cila të thirret nga të dhënat e regjistruara në regjistrin e tatimeve për secilin biznes)
- Emri i biznesit
- Adresa e biznesit
- Rajoni ku e ushtron aktivitetin
- Sektori i aktivitetit
- Nr. telefoni i biznesit
- E-mail i biznesit
- Pozicioni i punës në përputhje me kontratën e punës
- Data e menduar e fillimit të punësimit
- Data e mbarimit
- Paga mujore bruto

Për rinovim Leje Unike,

- Punëdhënës i ri / i mëparshëm
- Pagar sigurimet për vitin paraardhës

- Aneksi 9,

- a) Në titullin e Aneksit 9, fjala “...për kategori të veçanta” zëvendësohet “...për motive të tjera”
- b) Në formularin “Leje qëndrimi për motive të tjera”, në pjesën “Karta B” përfshihet kategoria “për investitor”;
- c) Në Seksionin 3.1 “Arsyet e qëndrimit”, në pjesën “Cilat janë arsyet e qëndrimit tuaj në Shqipëri?” shtohet kategoria “Për Investitor”;
- ç) Në seksionin 3.3, “Të ardhurat dhe sigurimi shëndetësor”, në pjesën “Unë kam bashkangjitur vërtetimet e mëposhtme së bashku me aplikimin”, shtohen këto dokumente:
 - Vërtetim regjistrimi në QKB me vlerën e investimit të miratuar nga ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe ministri përgjegjës për ekonominë dhe inovacionin.
 - Plan Biznesi.

- 7. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtar.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA